



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:188350

Datë: 23.01.2023

Numri i dokumentit: 03891925

**PKR.nr.176/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**- Departamenti për krime të rënda, me Kryetaren e trupit gjykues Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Besa Dervishaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A.H.nga P., L. “D. ..”, rr. “T. Sh.”, nr.. për vepër penale, “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për vepër penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda PP/I.nr.243/22 të datës 15.09.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencë të Prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të akuzuari A.H. si dhe mbrojtësit të tij me autorizim av.Shpejtim Berisha, e në mungesë të palës së dëmtuar M. Sh., me datë 29.12.2022 mori dhe shpalli, si dhe me datë 18.01.2023 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

A. H., i biri i L. dhe i nënës S. e gjinisë Z., i lindur me datë ..... në P., ku edhe jeton L. “D. ...”, rr. “T. Sh.”, nr., i fejuar, ka të kryer shkollën e mesme, punon në një market familjar, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër ..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Për shkak se:

**I akuzuari Arber Hasanaj**

I. Më parë e gjerë me datë 10.08.2022, rreth orës 01:35 në P., pa autorizim e në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll armën dhe atë pistoletën model Z. ...- prodhim T., e cal.mm, një karikator të njëjtës armë si dhe ... fishekë të gjallë me gaz, në atë mënyrë që natë[n kritike policia gjatë kontrollit dhe bastisjes në banjo në pompën e derivateve ish “Q. P.”, policia pas guacës gjejnë dhe sekuestrojnë armën dhe municionin e cekur si më lartë.

-Me çka ka kryer vepër penale “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

II.Me datë 10.08.2022 në ora 01:35 min, në P.e pikërisht para marketit “A.” në P., e cila gjendet te udhëkryqi për në f. L., me qëllim të frikësimit ka përdorur armën dhe atë pistoletën e modelit Z.... -.. prodhim T., e cal.. mm, një karikator të njëjtës armë dhe tre fishekë të gjallë me gaz, në atë mënyrë që gjatë një përleshje që kishte ndodhur natën kritike para marketit “A.”, i pandehuri e merr armën dhe të njëjtën ia drejton të dëmtuarit M. Sh., dhe në momentin kur policia arrijnë në vendin e ngjarjes, i pandehuri e merr armën dhe të njëjtën e fsheh në banjën e pompës së derivateve ish “Q. P.” në P.,

-Me çka ka kryer veprën penale – “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e neneve 7, 17, 21 par. 2, 38, 39, 40, 42,43,44, 69,70, 76 par.1 dhe 2 të KPRK-së, neni 366 par.1 të KPRK-së, neni 367 par.2 të KPRK-së, të akuzuarin e :

## G J Y K O N

1.Të akuzuarit për veprën e parë penale si në dispozitivin **I** të cekur si më lartë i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 400€ (katërqind euro),

2. Të akuzuarit për veprën e dytë penale si në dispozitivin **II** të cekur si më lartë i caktohet dënim me gjobë në shumë prej 300€ (treqind euro), dhe me burg në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, me pëlqimin e të akuzuarit dënimi me burgim i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej 1000 € (njëmijë euro).

3.Konform neni 76 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej 1700€ (njëmijë e shtatëqind euro), e të cilin dënim obligohet që ta paguaj më së largu në afat prej 3 (muaj) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse dënimin unik me gjobë të cekur si më lart nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj në afat të caktuar, atëherë i njëjti do të shndërrohet me dënim me burg, duke ju llogaritur një ditë burg për çdo 20€ (njëzet euro) të gjobës.

4.Te akuzuarit i konfiskohet një pistoletë model Z.... -.., prodhim turk e cal.. mm, një karikator i të njëjtës armë si dhe tre fishekë të gjallë me gaz, të cilat do të shkatërrohen pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5.I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës të ia paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në emër të kompensimit për viktimat e krimin, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

6.I dëmtuari M. Sh. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për krime të rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.243/22 të datës 15.09.2022, ndaj të akuzuarit ndaj të akuzuarit A. H. nga P., L. “D. ..”, rruga “T. Sh.”, nr.. për vepër penale, “mbajta në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe për vepër penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” nga neni 367 par.2 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit PP/I.nr.243/22 të datës 15.09.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe i akuzuari A. H. ka deklaruar: se pasi që i kam kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë të cilat më janë shpjeguar nga ana e gjykatës, deklarom se e pranom fajin për dy veprat penale për të cilat akuzohet, e pranom fajin vullnetarisht pa presion.

Prokurori i shtetit ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kështu që i propozom Gjykatës që të njëjtën ta aprovoj. Ndërsa sa i përket rrethanave për dënimin i propozom Gjykatës që si rrethanë lehtësuese ta vlerësoi pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, për faktin që më parë i njëjti nuk ka qenë i dënuar, kurse si rrethanë rënduese nuk kanë gjetur.

Mbrojtësi i të akuzuarit av, Shpejtim Berisha ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë. I mbrojturi i tij ka qenë bashkëpunues dhe se i njëjti e ka pranuar fajësinë në polici, prokurori si dhe në shqyrtim fillestar për veprat penale që i vihen në barrë, andaj si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, është hera e parë që i njëjti ka ra ndesh me ligjin dhe se i njëjti nuk ka pasur për qëllim që ta dëmtoi personin M. Sh., mirëpo ka ndodhur një keqkuptim me të njëjtin janë pajtuar familjarisht, gjithashtu me rastin e dënimin i propozom Gjykatës ta dënoi me gjobë për arsye se i njëjti është duke vuajtur një sëmundje kronike dhe atë në zorrë të trash dhe se vetëm gjatë këtij viti disa herë ka qenë për vizita mjekësore në shtetin e S. dhe në M. e V., për çka Gjykatës i dorëzojnë disa raporte mjekësore të kontroleve të kohëpaskohshme. I njëjti është duke shikuar për të shkuar në shtetin e S. për shërim për çka do ti pa mundësohet udhëtimi dhe pajisja me vizë në qoftë se do të dënohet me një dënim tjetër, gjykata të ketë parasysh se i njëjti është punëtor në market dhe se ka të ardhura mesatare me një rrogë prej 350€.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimin.

Bazuar në pranimin e fajësisë dhe duke pasur parasysh provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: raporti i oficerit K. G. me numër ....-.-..... të datës 31.07.2022, raporti i oficeres F. I. e datës 31.07.2022, lista e armëve të konfiskuara e datës 31.07.2022 e lëshuar në emër të A. H., fotoalbumi, gjykata erdhi në përfundim se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementët e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e për të cilin është shpallur fajtor.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se e kanë pranuar fajësinë qysh në fillim, për gjykatën nuk ka të dhëna se i njëjti më parë ka ra ndesh me ligjin, ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin e lartcekur gjykata nuk ka gjet asgjë.

Gjykata bazuar në dispozitën e nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit ka zëvendësuar dënimin me burgim në dënim me gjobë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi konfiskimin të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit në paguarjen e paushallit gjyqësor të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori Konform nenit 450 të KPRK-së,

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit në paguarjen e shumës së cekur për viktimat e krimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e mori konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit.

I dëmtuari M. Sh. nuk ishte prezent në seancë fillestare. Andaj gjykata e udhëzoi në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës parurore juridike eventuale konform nenit 463 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPRK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,**

Kryetarja e trupit gjykues

\_\_\_\_\_  
Violeta Husaj Rugova

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.